



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 4, datë 13.01.2023

PËR

**NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.155, DATË 22.12.2022
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT
NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1,4,5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI,
BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË
RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA
NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të ankesit nr.1 në VKB-në nr.155, datë 22.12.2022 për shkak të një gabimi material duke hequr nga aneksi nr.1 subjektin përfitues Ahmet Osman Konçi, me numër rendor 2, me përbërje familjare 2 persona.

2. Miratimin e shtesës së aneksit nr.7 në VKB- në nr.155, datë 22.12.2022 me titull “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Nr.2”, si më poshtë:

ANEKSI 7. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.2

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	26662	AHMET	OSMAN	KONÇI	2	PRISHJE	PO

3. Miratimin e ndryshimit të emërimit të VKB- së nr.155, datë 22.12.2022 si më poshtë :
“Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në njësitë administrative nr.1,2,4,5, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 16.01.2023



BASHKIA DURRËS
24.01.2023 Nr. 42/4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 49/prot.
4

Durrës, më 24.01.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 4 datë 13.01.2023 “Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.155, datë 22.12.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në njësitë administrative nr. 1,4,5, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

